

VENDIM
Nr. 921, datë 25.11.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 509, DATË 1.7.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE
PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2020”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

Në vendimin nr. 509, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, fjalët “ ... gjithsej 21, ...” zëvendësohen me “ ... gjithsej 30, ...”.
 2. Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Numrat 4 dhe 10, të ndarjes I, “Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë – kategoria II-b;
 10. Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Brendshme – kategoria II-b;”.
 - b) Në ndarjen II, “Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - i. numri 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve – kategoria III-a”;
 - ii. pas numrit 21, shtohen numrat nga 22 deri 30, me këtë përmbajtje:

“22. Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier – kategoria III-a;

23. Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë – kategoria III-a;

24. Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë – kategoria III-a;

25. Drejtor Rajonal i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat – kategoria III-a;

26. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër – kategoria III-a/1;

27. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve – kategoria III-a;

28. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë – kategoria III-a/1;

29. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër – kategoria III-a/1;

30. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë – kategoria III-a/1.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama